



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
KËSHILLI BASHKIAK

Pustec, më 24.03.2026

PROCESVERBAL

Lloji i mbledhjes: e rregullt

Vendi i mbledhjes: salla e mbledhjeve të Këshillit

Ora e fillimit: 12⁰⁰

Kryeson mbledhjen: kryetari i këshillit z.Naum Damo

Të pranishëm nga administrata janë: sp.PAK, znj.Para Trajko, përgj.sekt financës z.Cvetko Nasto, sp.finance znj.Elena Argjiri, përgj.shërbimeve z.Spase Taërpo, sh.mzsh z.Niko Male, sp.jurist znj.Klodjana Sotiri.

Këshilltarë të pranishëm në sallë janë: Naum Damo, Spase Tërpo, Vaska Vasilovski, Taqo Grozdani, Jani Apostol, Nada Gjoli, Bllagica Mihal, Sandi Nikolla, Aida tarjanof, Adelina Tërpo.

I pranishëm në mbledhje Kryetari i Bashkisë z.Pali Kolefski

Kryetari i këshillit: përshëndetje të gjithëve, fillojmë me kourumin e mbledhjes, këshilltarë të pranishëm janë **dhjetë**, kuorumi miratohet. Faleminderit!

Në mbështje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 52 “konflikt interesi” të gjithë këshilltarët që jemi të pranishëm duhet ta plotësojmë deklaratën e konfliktit të interesit.

Shënim: një këshilltar është në konflikt interesi menjë nga pikat e rendit të ditës që është pasqyruar tek deklaratat e plotësuar nga ana e tij dhe nuk ka votuar për atë pikën

Faleminderit!

Vazhdojmë me shtjellimin e pikave të rendit të ditës

1.Për miratimin e rendit të ditës së mbledhjes

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

2.Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

3. Për miratimin e bllok ndihmës ekonomike nga fondi 6% për muajin janar 2026

Sp.NE-përshëndetje, në bazë të verifikimeve të bëra nga grupi i kontrollit i ngritur nga ana e Bashkisë për verifikimin e familjeve të cilët kanë dalë jo përfituese nga skema e ndihmës ekonomike ,të cilat do të trajtohen nga fondi i kushtezuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6% rezulton për këtë muaj kemi ndryshime është shtuar z.Cvetko Sterjo, znj.Petra Jankulla dhe është hequr z.Kërstin Sotiri.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

4. Për dhënien e ndihmës së menjëhershme

Sp.PAK – mbledhjen e kaluar e diskutuam kërkesën e paraqitur nga znj.Anastasia Vasilovski dhe tani kemi përgatitur projekt aktin dhe relacionin shoqërues, ndihma financiare nga fondi i ndihmës së menjëhershme e ofruar nga Bashkia Pustec do të jetë në masën 50 000 lekë për të përballuar disa nga nevojat bazë për shkollimin e djalit të saj.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

5.Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA-së 2027-2029 (faza e parë)

Sp.financës- në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027–2029”, paraqesim për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për vitet 2027–2029. Pasqyrat financiare janë hartuar mbi transfertat nga Ministria e Financave, nga të ardhurat e trashëguara dhe nga buxheti për vitin 2026. Mbi këto tavane do të punojnë edhe drejtuesit e EMP –së për përgatitjen e programeve dhe projekteve buxhetore. Bazuar në këto të dhëna, janë përcaktuar tavanet orientuese për periudhën afatmesme 2027–2029, të cilat synojnë një menaxhim të qëndrueshëm financiar dhe një shpërndarje sa më efektive të burimeve në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike për komunitetin. Tavanet përgatitore janë ndërtuar sipas formatit standard të Instrumentit të Planifikimit Financiar (PSHP2), ndërsa shpërndarja e burimeve financiare është realizuar në 9 programe buxhetore, në përputhje me formatin PSHP3, të bashkëlidhur materialit.

Tavanet gjithsej për vitin Viti 2027 135,552

Viti 2028 137,860

Viti 2029 140.592

Këshilltari Taqo Grozdani- nga ka ardhur kjo rritja për vitet 2027-2028-2029?

Sp.financë- janë nga transertat e Ministrisë së Financave dhe janë transfertat , buxheti qendror dhe nga të ardhurat e trashëguara dhe në bazë të këtyre bëhet parashikimi për vitet e ardhshme. Transfertat janë përcaktuar nga Ministria dhe kanë rritje 2 % për vitin 2027 dhe 2028 kuresë për vitin 2029 rritja është 3%.

Këshilltari Taqo Grozdani-pse ?

Sp.financës- i ka përcaktuar pra Ministria e Financave dhe në bazë të udhëzimit që dërgon në bazë të atyre është bërë shpërndarja e taveve dhe i pasqyrojmë tek dokumenti përkatës.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

6.Për disa ndryshime në VKB nr.101 datë 24.12.2025 Për miratimin e strukturën nivelin e pagave të administratës dhe agjencisë të Bashkisë Pustec për vitin 2026.

Sp.jurist- numri i punonjësve gjithsej është 110 e shpërndarë: administrata, shërbimeve , arsimit zjarëfikësve si dhe gjendjen civile, kemi bërë disa ndryshime në strukturën e bashkisë, ky është një organizim minimal dhe i domosdoshëm për përmushjen e funksioneve bazë të Vetëqeverisjes vendore. Ndryshimi po bëhet për shkak të shtesave që ka aprovur buxheti i shtetit. Në shërbimet kemi aplikuar VKM për pagën minimale kurse për administratën ka një VKM tjetër që ka ardhur me rritje për përcaktimin e minimumit dhe maksimumit në bazë të indeksimit të pagës, gjithashtu edhe për zjarëfikësit dhe arsimit parashkollor ka një VKM të re.

Këshilltari Taqo Grozdani-rritja është e njejtë për të gjithë?

Sp.jurist- në bazë të VKM për indeksimin e pagave

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

7.Për miratimin e sasisë së karburantit për automjetet e Bashkisë Pustec

8.Për miratimin e normës së karburantit për automjetet e Bashkisë Pustec.

Përgj.shërbimeve- nuk kemi ndonjë ndryshim të madh, janë ngritur komisione përkatëse për secilin sektor për ti verifikuar automjetet. Sivjet i kemi ndarë automjetet sipas sektorëve shërbime, administratë dhe mzsh dhe secili sektor do të përgjigjet dhe mbaj përgjegjësi për normën dhe sasinë

e karburantit. Komisioni i ngritur do të monitorojë harxhimin e karburantit të automjeteve sipas rregullores që ka.

Nga fillimi i vitit deri në fund ne kemi parashikuar se sa do të harxhojmë.

Këshilltari Taqo Grozdani- nga eksperiencia juaj ju i keni përmbushur kërkesat ose nevojat e transportit, ju nevojitet më shumë ose më pak karburant?

Përgj.shërbimeve- vjet kishim parashikuar më shumë karburant kurse sivjet kemi më pak. Nga eksperiencia që kemi sivjet jemi përmirësuar. Sivjet do ta ndërrojmë kaldanë e shkollës që është me naftë në Pustec dhe do ta zëvendësojmë me ngrohje me pelet.

Tani me rritjen e cmimit të karburantit si do të bëni?

Kryetari- bashkia funksionon në bazë të parashikimeve dhe ne do të përqendrohemi tek ato gjëra që janë më emergjente psh.pastrimi i mbeturinave ose ndonjë gjë tjetër në bazë të problemit që do të jetë.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? I kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

9. Për krijimin e një aseti të ri nga bashkimi i llogarive financiare.

10.Kalim investim me objekt “Furnizim me ujë të pijshëm për Bashkinë Pustec”, si shtesë kontributi në asetet e Bashkisë pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a.

Përgj.financës- propozohet krijimi i një aseti të ri në inventarin e Bashkisë Pustec, nëpërmjet bashkimit të disa llogarive financiare që lidhen me investimin për furnizimin me ujë të pijshëm. Ky investim, i realizuar në disa faza (studim, projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim dhe ndërhyrje elektrike), është regjistruar në mënyrë të ndarë, por përbën një objekt të vetëm funksional. Ky veprim nuk përbën shpenzim të ri buxhetor, por vetëm një riorganizim të të dhënave ekzistuese financiare.

Në kuadër të reformës për riorganizimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve dhe krijimit të shoqërive rajonale, Bashkia Pustec është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a., duke transferuar aktivitetin dhe detyrimet përkatëse. Në zbatim të marrëveshjeve dhe kontratave të lidhura, propozohet kalimi i investimit me objekt Furnizim me ujë të pijshëm për Bashkinë Pustec si shtesë kontributi në asetet e bashkisë pranë kësaj shoqërie.

Këshilltari Taqo Grozdani- a i keni paguar ju si institucion të gjitha detyrimet ndaj SHA Korçë?


Kryetari i Bashkisë- po , pasi ka dalë një VKM më duket për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të prapambetura.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? I kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 9 vota pro, 0 vota kundër, 1 votë abstenim. Faleminderit !

Kryetari i këshillit- për sa i përket pikës për diskutimet në lidhje me Raportin e monitorimit të buxhetit të Bashkisë Pustec për vitin 2025 do ta kalojmë për mbledhjen e ardhshme.
Faleminderit të gjithëve për prezencën tuaj. Këtu mbyllet mbledhja për muajin shkurt. Faleminderit!

MIRATUAN
Sekretar i këshillit

Todora TERPO



Kryetar i Këshilli

Naum DAMO